

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-1

M 36

STEFAN  
MARTIKO

Përanë  
shokëve



824-1

Nr 36.

**STEFAN MARTIKO**

**PRANË  
SHOKËVE**



**POEZI**

~~71248~~  
13242

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NDAJ KEMI KAQ SHUMË KËNGË

Diçka breron papushim, papushim,  
si shatërvanet nga toka, —  
ky me siguri është  
shpirti i pastër i popullit.

Njoh gjelbërimin e tokës sime  
të patharë në shekuj,  
të patharë në vite.

Unë e di, —  
gjithçka mund të ishte tharë një mot  
dhe unë e ti s'do të ishim më komb,  
po refugjatë të mjerë  
nëpër shtegtime të gjata,  
pa këto këngë, pa këto male  
që, si burra madhështorë,  
nga tisi i mjegullave dalin.

Ndaj kemi kaq shumë këngë,  
si koralet e pastra të verës  
që i pastron e i shumon  
gjithnjë deti.

## KËNGËT ÇELIN LULE

Ja ra pranvera  
mbi pyje, koriqe, male e qytete.  
Ra e një ngjyrë e bardhë, e bardhë  
veshi mëngjesin e marsit me lule.

Veshi Shqipërinë  
e ia ndezi ngjyrat në këngë.  
Hov shpirti me lulet në këngë.  
e ndizet nga ngjyrat një botë e tërë.

## FJALË PËR TOKËN

Jam bujku që më merr malli për tokën,  
parcelat i di, rendimentet i di.

Kur vijnë perëndimet  
dhe dielli tretet, tretet dhe mbytet  
në gropa të panjohura qiejsh,  
unë lëshoj ujin dhe arat pinë,  
pastaj ngrënë kokën të dehura bimët.

Jam bujku që e njoh tokën  
dhe çdo grimcë të saj në duar e shkërmoq.

Ka diçka që s'shkëputet midis meje dhe tokës.  
Bimët që rriten —  
fije të shumta mirënjohjeje!

## FUSHA MERR FRYMË

Ç'e ndritshme kjo natë, ç'e bukur!  
Nëpër fusha zgjohen kallinjtë  
dhe unë, si në një dasmë gëzimi,  
heq vellon e saj të purpurt.

Ç'u mbulua nata e tërë  
me këtë pëshpërimë jete.  
Eci unë dhe mijra njerëz  
në tragat e njohura të qerreve.

Një grusht yjesh mbaj në duar  
dhe eci mes për mes fushës;  
kaloj tani grunjërave  
me nderimin e madh për bukën.

Pika vese pikojnë  
si sumbulla ari  
dhe fusha merr frymë  
nga firoma të ngrohta fshatarësh.





shkëlqet idm. tona. mshk  
shkëlqet tona e tona. mshk  
tona e tona. mshk  
tona e tona. mshk  
**VAJZA E BRAZDAVE**

Flokët e zeza rënë mbi ballë,  
syve zjarri ç'u merr flakë;  
avull i ngrohtë prej tokës del,  
mbi fusha është akoma natë.

Ku shkon ashtu flokëlëshuar  
mbi fush' që dirs e avullon?  
Lenkë e bukur brigadiere  
ndërmjet brazdave nxiton.

Dita dyer hap e tutje  
njerëz shpie fushash larg.  
Në sy vezullon e ndrin  
det' i tërë pambuk i bardhë.

Sheh Lenkë e bukur fushash  
basmë e cohë mrekuillish  
«Për dasmat tona, — thotë, —  
u bëfsh  
i bukur fustan nusëri!»

Hëna shket mbi kallamishte,  
u zbeh drit' e saj sërish;  
yjet një nga një si zogj  
humbën qiellit në shtegëtim.

VALXA E BRADAVE

Flokët e veta të më mbi ballë,  
qyçet xjarr që merr flakë;  
nvali i ngrohtë prej tokës dol,  
mbi fusha është akoma natë.

Ku shkollon ashtu flokëshuar  
mbi fushë që dritë e avullon?  
Lanë e bukur përgjithërisht  
ndërrimet burxive nxiton.

Dita dyer hap e tutje  
njërës shpie fushash larg,  
Në sy veshin e natën  
dritë e tërë pambuk i bardhë.

Shpesh lanë e bukur fushash  
dritë e copë mrekullish  
— për dritat tonë — thotë —  
u bëjnë  
i bukur fustan nusejsh.